

STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“DIBRA FRUIT” Sh.p.k.

Mbi bazën e kërkesave të ligjit Nr. 9901 të datës 14.04.2008 “Përshoqëritë tregtare” dhe të ligjit Nr. 9723 të datës 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” krijohet shoqëria tregtare “DIBRA FRUIT” sh.p.k., e cila do të veprojë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

KAPITULLI I
EMËRTIMI, OBJEKTI I VEPRITARISË, SELIA , KOHËZGJATJA

NENI 1
EMËRTIMI I SHOQËRISË DHE THEMELUESIT

Krijohet shoqëria tregtare e emërtuar “DIBRA FRUIT” sh.p.k., me ortakë:

1. Ortaku Z.Robert Zebi, lindur në Ushtelenxë, Dibër, Shqiperi, më 01.04.1988, i identifikuar me Nr. Letërnjoftimi I80401004T;

NENI 2
SELIA

Shoqëria e ka selinë e saj në adresën: Njësinë Administrative Tomin, Zona Kadastrale 3605, me Nr Pasurie 64/27, Vol 1, faqe 130, Dibër, Shqipëri .

Shoqëria mund të çelë, seli të tjera të dyta, degë, përfaqësimi apo agjenci operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, në përputhje me ligjin në fuqi.

NENI 3
KOHËZGJATJA

Shoqëria do të ketëkohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me një afat kohor të pacaktuar.

NENI 4
VULA

Shoqëria do të ketë vulën e saj.

NENI 5
OBJEKTI

Shoqëria do të ketë Statutin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe do të përballojë humbje deri në kufirin e kontributit të themeluesve të saj në kapitalin fillestar.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

Import-eksport, shitje me shumicë dhe pakice të fruta-perimeve, agrumeve, produkteve agrikutuore të të gjitha llojeve, fruta të thata etj.



KAPITULLI II
KAPITALI

NENI 6
KAPITALI THEMELTAR

Kapitali fillestarë i shoqërisë është i barabartë me 100000 (njqindmije) lekë, i cili miratohet nga ortaku i vetëm, dhe nuk është i derdhur nga ortaku themelues dhe ndahet në 1 (një) kuotë me vlerë 100000 (njqindmije) leke, që përben 100 % (njqind për qind) të kapitalit të shoqërisë;

Kapitali është i ndarë mes ortakut themelues si më poshtë:

- 1) Ortaku Z.Robert Zebi.mbjtës i 1 (një) kuote me vlerë nominale të barabartë me 100000(njqindmije) lekëqëpërben 100% (njqindpër qind) të kapitalit të shoqërisë;

NENI 7
PJESËMARRJET NE KAPITALIN THEMELTAR

Pjesëmarrjet e ortakëve në kapitalin themeltar përcaktohet në raport të drejtë me kontributet e tyre në kapitalin themeltar.

Të drejtat, përfshirë edhe të drejtat e votës, u takojnë ortakëve në mënyrë përpjesëtimore me pjesëmarrjen që zotëron secili ne kapitalin themeltar.

Ne rast tjetërsimi të pjesëmarrjes në kapitalin themeltar, ortakët e tjerë gëzojnë te drejtën e parablerjes. Me "tjetërsim" nënkuptojmë çdo akt tjetërsimi i kuotave, në kuptimin më të gjerë të fjalës, si në pronësi të plotë ashtu dhe të pjesshme, që në mënyre direkte apo indirekte, sjell ndryshimin e titullit të pronësisë mbi kuotat ose të drejtat mbi to.

Ortaku që synon të tjetërsojë, tërësisht ose pjesërisht, kuotat e tij ne kapitalin themeltar duhet t'i komunikojë ortakëve të tjerë në asamble ose nëpërmjet letre rekomande, ofertën e marre, duke treguar emrin e blerësit të mundshëm dhe kushtet e tjetërsimit, në mënyrë të veçantë çmimin e përcaktuar dhe mënyrat e pagesës (këtu e me poshtë oferta).

Brenda njëzet ditëve nga marrja e komunikimit te Ofertës, ortakët e interesuar në ushtrimin e së drejtës së parablerjes duhet t'i komunikojnë ortakut që kalon të drejtat mbi kuotat, dëshirën për të ushtruar te drejtën e parablerjes, përpjesëtimisht me pjesëmarrjen e secilit në kapitalin themeltar dhe sipas kushteve te Ofertës, duke shprehur edhe interesin e mundshëm për blerjen e pjesës se kuotave për te cilën nuk është ushtruar e drejta e parablerjes nga ana e ortakëve të tjerë. Është i pavlefshëm çdo komunikim që nuk përmban të gjithë të dhënat e mësipërme.

Në rast se ndonjë nga personat që gëzon të drejtën e parablerjes se kuotave, nuk mund ose nuk dëshiron ta ushtronte atë, e drejta e parablerjes që i takon zmadhohet automatikisht dhe përpjesëtimisht në favor te ortakëve që kanë shprehur interesin për ta ushtruar këtë te drejte.

Në rast se janë disa ortakë që ushtrjnë të drejtën e parablerjes, kuotat do të shpërndahen ndërmjet tyre në përpjesëtim me pjesëmarrjen e secilit në kapitalin themeltar të shoqërisë. Në rast se në letrën e komunikimit të Ofertës tregohet si blerës i mundshëm një person që është ortak, edhe atij i njihet e drejta e parablerjes, krahas ortakëve të tjerë.

E drejta e parablerjes duhet të ushtrohet për të gjithë pjesëmarrjen e ofruar dhe për çmimin e përcaktuar, duke qenë si i tillë është objekti i propozimit të paraqitur nga ortaku ofrues.



Në rastin e ushtrimit të së drejtës së parablerjes, nënshkrimi i kontratës së shitjes së kuotave dhe pagesa përkatëse duhet të kryhen brenda afateve të përcaktuara në propozimin e shitjes së formular nga ortaku ofrues.

Nëse e drejta e parablerjes nuk ushtrohet brenda afateve të mësipërme dhe për tërësinë e pjesëmarrjes së ofruar, ortaku ofrues mund t'i transferojë kuotat e veta në favor të blerësit të treguar në komunikimin e Ofertës dhe në kushtet e parashikuara në të, brenda gjashtëdhjetë ditëve të ardhshme. Në të kundërt procedura e parablerjes duhet të përsëritet.

Në rast tjetërsimi të kuotave në favor të të tretëve, pa zbatuar dispozitat e parashikuara me sipër, blerësi nuk do të legjitimohet në ushtrimin e të drejtave administrative dhe pasurore dhe tjetërsimi i kuotave nga ana e tij nuk do të prodhojë efekte ndaj shoqërisë.

Nëse asnjëri prej ortakëve nuk e ushtron të drejtën e parablerjes në mënyrat e përcaktuara, ortaku ofrues mund të nënshkruajë aktin e shitjes së pjesës së tij në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. E drejta e parablerjes nuk është domosdoshmërisht e nevojshme të ushtrohet prej ortakëve, në rast transferimi tek familjarët, të kuotave ose të pjesëve të kuotave të zotëruara prej tyre.

NENI 8 ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet ose të pakësohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, por asnjëherë nuk mund të zvogëlohet nën nivelin e kapitalit fillestar të derdhur.

NENI 9 TRANSFERIMI I KAPITALIT

Kuotat e kapitalit tënjëshoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a. Kontributit fillestar;
- b. Shitblerjes;
- c. Trashëgimisë;
- d. Dhurimit;
- e. Çdo mënyretjetër të parashikuar në ligj.

Ortaku mund të shesë pjesërisht apo tërësisht kuotat e tij të kapitalit. Shitja e kuotave tek të tretët bëhet vetëm pasi të ketë marrë vendim Asambleja e Ortakëve dhe nëpërmjet kontratës së shitjes së kuotave të kapitalit.

KAPITULLI II ORAGENET DREJTUESE

NENI 10 ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve;
- Administratori.



NENI 11 ORGANI VENDIMARRËS

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëvendimmarrës i shoqërisë, ortakët vendosin mbi çështjet që i rezervohen nga ligji ose nga ky Statut, si dhe mbi çështjet që njëri ose disa prej administratorëve i paraqesin për miratim.

Ortakët gëzojnë te drejtën te thërrasinasambleshë e ortakeve në rastet dhe me shumicat e përcaktuara në ligj.

Janë në çdo rast në kompetencë të Asamblesë që vendos me shumicë të thjeshtë te votave të ortakëve pjesëmarrës kur janë prezent me shumë se 30 % e kuotave të kapitalit themeltar, për vendimet që kërkojnë shumicë të zakonshme, si mëposhtë:

1. Emërtimin e shkarkimin e administratorit;
2. Emërtimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar, duke përcaktuar në këtë rast kriteret e likuidimit;
3. Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në pikën 1 dhe 2;
4. Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo Statuti.

Janë në kompetencën e Asamblesë së Ortakëve e cila vendos me votën në favor te $\frac{3}{4}$ të ortakëve prezent që përfaqësojnë më shumë se gjysmën e kapitalit të shoqërisë, vendimet që kanë lidhje me :

1. Miratimin e bilancit dhe shpërndarjen e fitimeve;
2. Ndryshimet e këtij statuti;
3. Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit themeltar;
4. Ndryshimin e formës së shoqërisë apo riorganizimin e saj;
5. Shpërndarjen e shoqërisë.

Asambleja mund te mblidhet në mënyrë të jashtëzakonshme kur e kërkojnë administratori apo më shumë se një e treta e ortakëve të shoqërisë. Në mbështetje të nenit 88 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ortakët kanë të drejtë për të marrë unanimisht çdo vendim, me kusht që kjo marrëveshje të bëhet me shkrim.

NENI 12 MBLEDHJA E ASAMBLESË

Asambleja e Përgjithshme mblidhet në rastet e parashikuara nga ky Statut dhe në rastet e përcaktuara nga ligji nr. 9901, i 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ligje të tjera, dhe çdo herë është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Takimi i rregullt i Asamblesë së Përgjithshme është bërë të paktën një herë në vit.

Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratori ose nga ortakët në përputhje me nenin 12 të këtij statuti.

Asambleja e Përgjithshme mblidhet në qoftë se, nga pasqyrat financiare vjetore apo prospektet e rezultateve të ndërmjetme, ekziston rreziku që fitimet e kompanive nuk i mbulojnë detyrimet e duhura për 3 muajt e ardhshëm.

Asambleja e Përgjithshme mblidhet kur shoqëria, brenda dy viteve të para të krijimit të saj, propozon të blejë nga një ortak, asetet me një vlerë mbi 5% të aseteve të shoqërisë që rezulton nga deklaratat e fundit financiare e certifikuar.

Në rastet e parashikuara në pikat 3 dhe 4 të këtij neni, duhet t'i paraqitet Asamblesë së Përgjithshme një raport i detajuar nga një kontabilist i autorizuar me licencë i pavarur.



Nëse asambleja nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit, mbledhja thirret përsëri brenda 30 ditëve me të njëjtin rend dite.

NENI 13 THIRRJA E ASAMBLESË

Asambleja e ortakëve e thirrur rregullisht përfaqësonbashkësinë e ortakëve dhe vendimet e saj të marra nëpërputhje me ligjin dhe këtë statut janë të detyrueshme për të gjithë ortakët edhe nëse këta mungojnë ose nuk janë të tënjëjt mendim.

Asambleja e Ortakëve thirret me një njoftim me shkrimdërguar ortakëve në vendbanimin e tyre ose në adresën e postës së tyre elektronike.

Njoftimi me shkrim ose me e-mail, duhet të tregojë vendin, datën dhe orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe duhet t'i komunikohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë para datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë.

Njoftimi për thirrjen e asamblesë është bërë me shkrim dhe do të dorëzohet për secilin ortak në adresën e regjistruar në regjistrin e ortakëve të paktën 7 (shtatë) ditë para mbledhjes.

Përveç sa mësipër, njoftimi për thirrjen e asamblesë mund të bëhet nëpërmjet dorëzimit të tij administratorit, ky i fundit ka përgjegjësinë e dorëzimit të këtij njoftimi, ortakëve .

Në numërimin e shtatë ditësh nuk merret parasysh, dita e dorëzimit të njoftimit dhe dita e mbajtjes së mbledhjes.

Kur asambleja nuk është mbledhet në mënyrën e përshkruar më lart, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në qoftë se është përfaqësuar tërësia e kapitalit themeltar dhe asnjë nga anëtarët nuk kundërshtojnë diskutimin e çështjeve në rend të ditës.

Asambleja drejtohet nga administratori. Drejtuesi i Asamblesë konstaton mbledhjen e rregullt të saj, verifikon identitetin dhe legjitimitetin e të pranishmëve, drejton dhe garanton zhvillimin e rregullt të saj të asamblesë si dhe verifikon dhe shpall rezultatet e votimeve.

Mbledhja e Asamblesë së ortakëve mund të mbahet edhe nëpërmjet video- konferencës ose telekonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe të dallohen në çdo moment të lidhjes dhe t'u lejohet të ndjekin diskutimin, të marrin , të dërgojnë dhe të vëzhgojnë dokumentet, të ndërhyjnë gojarisht dhe në kohë reale mbi të gjitha çështjet, si dhe të marrin pjesë në votim dhe të vendosin, në mënyrë të tillë që të mund të garantohet metoda kolegjiale dhe zbatimi i parimeve të mirëbesimit dhe barazisë së trajtimit të ortakëve. Në prani të kushteve të mësipërme, asambleja e ortakëve konsiderohet e mbajtur në vendin në të cilin gjendet drejtuesi i saj ose në vendin që tregohet në njoftimin e mbledhjes së saj. Çdo ortak ka të drejtën e pjesëmarrjes dhe të votës në asamble nëpërpjesëtim me pjesëmarrjen që zotëron në kapitalin themeltar.

Ortakët mund të përfaqësohen në asamble nga persona të tjerë nëpërmjet një autorizimi apo prokurë të posaçme. Autorizimi apo Prokura është e vlefshme vetëm për asamblesën për të cilën kërkohet, të identifikuar sipas rendit të ditës gjithashtu përfshin takime pasuese me të njëjtin rend dite. Ortakët nuk mund të përfaqësohen nga administratori i shoqërisë.

Vota duhet të jetë e hapur ose gjithsesi të shprehet me modalitete të tilla që të bëjnë të mundur identifikimin e ortakëve që nuk janë të tënjëjt mendim. Modalitetet e votimit miratohen nga Asambleja e ortakëve me shumicën e të pranishmëve, mbi propozimin të administratorit.



NENI 14
AKTET DHE VERBALET E MBLEDHJES SË ASAMBLESË

Vendimet e Asamblesë së Ortakëve duhet të pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes. Administratorët janë përgjegjës për ruajtjen e procesverbalit të mbledhjes së asamblesë. Procesverbali duhet të ketë datën dhe vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e Presidentit dhe i cili e mban procesverbalin, rezultatet e votimit. Procesverbalit të Asamblesë i bashkëngjitet lista e pjesëmarrësve dhe njoftimi për mbajtjen e takimit. Procesverbali i mbledhjes do të nënshkruhet nga të gjithë ortaket e pranishëm dhe nga ai që e përpilonatë.

NENI 15
KUNDËRSHTIMI I VENDIMEVE TË ASAMBLESË

Administratorët dhe secili ortak ka të drejtë të ankohet për vendimet e asamblesëpranë Gjykatës së Shkallës së Parë, ku është selia e kompanisë, nëse vendimet janë në kundërshtim me ligjin ose me statutin. Citati, i përshkruar në paragrafin e mëparshëm, është drejtuar kundër shoqërisë dhe duhet të dorëzohet brenda 3 (tre) muaj nga vendimi. Nëse vendimi është kundërshtuar nga ana e administratorit të shoqërisë, Gjykata e Shkallës së Parë, ku Selia shoqëria, emëron një përfaqësues të shoqërisë në gjykatë. Gjykimi i pavlefshmërisë ka efekt në lidhje me të gjithë ortaket dhe administratorët. Për raste që nuk rregullohen në këtë statut do aplikohet ligji.

NENI 16
ADMINISTRIMI

Asambleja e Ortakëve ka të drejtë të vendosë nëse administrimi i shoqërisë do të bëhet nga një administrator i vetëm apo nga Këshilli Administrativ i përberë nga minimumi 3(tre) dhe maksimumi 5 (pesë) administratorë. Administrimi i shoqërisë i cili konsiston në kryerjen e të gjithë veprimeve të administrimit për realizimin e objektit të veprimtarisë së shoqërisë, i besohet administratorit të vetëm ose Këshillit Administrativ. Në rastin e Këshillit Administrativ secili nga administratorët është i detyruar të informojë Këshillin për çdo veprim të kryer dhe në rast kundërshtishë vendos Asambleja e Ortakëve. Administratori i vetëm ose Administratorët (nëse janë emëruar qëndrojnë në detyrë 5(pesë) vjet, me të drejtë riemërimi, përveç nëse shkarkohen nga Asambleja e Ortakëve apo rastet e dorëheqjes. Kushdo që administron shoqërinë përgjigjet personalisht përballë saj dhe të tretëve për shkelje të mundshme të ligjit dhe ose statutit dhe ose gabimet e kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Në rast të administrimit me Këshill Administrativ, ky zgjedh brenda tij President dhe një Administrator të Deleguar. Presidenti i Këshillit të Administrimit duhet të thërrasë Këshillin të paktën një herë në dy muaj dhe të njoftojë Këshillin e Administrimit për mbarëvajtjen e shoqërisë. Nëse ekzistojnë mosmarrëveshje ndërmjet administratorëve, Presidenti duhet të thërrasë Asamblenë e Ortakëve, e cila mund të vendosë në lidhje me kundërshtitë. Në rastin e Këshillit Administrativ, administratorët mund të veprojnë bashkëose veç e veç. Në çdo rast, nëse ekzistojnë kundërshtime ndërmjet administratorëve këta i drejtohen Asamblesë së ortakëve, e cila dhe mund të zëvendësojë Këshillin e Administrimit e të emërojë administratorë të tjerë. Administratori ose Këshilli Administrativ mund të shkarkohen në çdo moment me vendim të Asamblesë së Ortakëve me votën pro të ortakëve që përfaqësojnë shumicën e kapitalit të shoqërisë.



pa detyrim motivimi. Megjithatë nëse shkarkimi është bërë pa arsye të drejtë, administratori mund të kërkojë dëmshpërblim financiar.

Në rastin e dorëheqjes së një administratori, brenda 30 (tridhjetë) ditëve duhet të thirret Asambleja e Ortakëve për emërimin e administratorit të ri, në rast se ky vendim nuk merret në të njëjtën mbledhje Asambleje kur është vendosur largimi i administratorit.

Shoqëria e themeluar do të administrohet nga një administrator i vetëm i cili do të qëndrojë në detyrë për një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë rizgjidhje.

Me themelimin e shoqërisë, emërohet Administrator Z. Robert Zebi, lindur në Ushtelenxë, Dibër Shqipëri, me 01.04.1988, e identifikuar me letërnjoftimin me Nr Personal I80401004T, për 5 vjet. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në QKR.

NENI 17 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratori ka të gjitha kompetencat për administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë, me përjashtim të vendimeve që ligji, statuti, akti i themelimit i rezervojnë Asamblesë së Ortakëve.

Administratori gëzon të drejta të pakufizuara në lidhje me administrimin e llogarisë rrjedhëse të shoqërisë pranë çdo banke, hapjen dhe mbylljen e llogarive rrjedhëse në çdo moment pranë çdo banke, administratori ka të drejtë për kryerjen e çdo veprimi dhe /ose operacioni që evlerësojnë të dobishëm për realizimin e objektit të shoqërisë.

Administratori drejton veprimtarinë e shoqërisë dhe ka të drejtë që ta përfaqësojë atë në marrëdhëniet me të tretët.

Përveç asaj çka parashikohet nga ligji, Administratori ka detyrën e kryerjes së veprimeve të mëposhtme:

1. Përgatit dhe harton inventarin, të llogarive vjetore dhe raportit me shkrim mbi administrimin, raportin e ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë, në mbyllje të çdo viti financiar dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, ja dërgon Asamblesë së Ortakëve për miratim;
2. Hartimin e projekteve të bashkimit ose të ndarjes së shoqërisë;
3. Të informojë asamblenë mbi zbatimin e politikave tregtare dhe realizimin e operacioneve tregtare me rëndësi për shoqërinë;
4. Të raportojë përpara Asamblesë së Ortakëve mbi faktet që mund të kenë pasoja negative mbi ecurinë apo ekzistencën e shoqërisë;
5. Administratorët mund të delegojnë përfaqësues të posaçëm për kryerjen e akteve të veçanta ose të një kategori aktesh, duke përcaktuar kompetencat përkatëse;
6. Të thërrasë Asamblenë e Ortakëve në rastet e parashikuara me ligj;
7. Si dhe çdo të drejtë tjetër e cila është përcaktuar me ligj për arritjen e qëllimit të shoqërisë

NENI 18 PËRFAQESIMI I ADMINISTRATORIT

Administratori ka të drejtën e përfaqësimit të shoqërisë kundrejt të tretëve dhe në gjykim. Ai mund të caktojë avokate dhe përfaqësues të shoqërisë përpara organeve gjyqësore, organeve të administratës shtetërore dhe të tretëve, si dhe përfaqësues të posaçëm për akte të veçanta apo kategori aktesh.



E drejta e firmës së shoqërisë mund të ushtrohet edhe nga personat të cilëve u është deleguar kjo e drejtë brenda kufijve të kompetencave të dhëna.

Administratori ka të drejtën e rimbursimit të shpenzimeve të bëra gjatë ushtrimit të funksioneve si dhe një shpërblim vjetor të përcaktuar nga asambleja e ortakëve në momentin e emërimit ose me vendim të posaçëm.

KAPITULLI IV **VITI FINANCIAR**

NENI 19 **VITI FINANCIAR**

Veprimtaria ekonomiko-financiare e shoqërisë nis me regjistrimin e saj në organet tatimore, ndërsa për vitet në vijim nga data 1 Janar deri më 31 Dhjetor të çdo viti.

Në fund të çdo periudhe të ushtrimit të aktivitetit hartohet bilanci kontabël, brenda afateve dhe konform ligjeve në fuqi.

Dokumentet e kontabilitetit, të shoqëruar nëse e nevojshme nga relacioni i ekspertit kontabël të autorizuar, duhet t'u komunikohen ortakëve dhe të vihen në dispozicionin e tyre pranë selisë së shoqërisë, të paktën 15 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë.

Shoqëria ka llogarinë rrjedhëse të saj si dhe librat kontabël në përputhje me kërkesat e ligjit për kontabilitetin dhe dispozitave të tjera fiskale në Republikën e Shqipërisë

Transferimi i vlerave monetare dhe transaksionet financiare do të kryhen në bazë të kriterëve të përcaktuara nga Banka e Shqipërisë.

NENI 20 **MARRËDHENIET E PUNËS**

Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratave të punës dhe konform Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

NENI 21 **FITIMET**

Fitimet që rezultojnë nga aktiviteti ushtrimor do të shpërndahen ndërmjet ortakëve pasi të jenë zbritur nga kjo shumë vlera e humbjeve të pësuar gjatë vitit ushtrimor paraardhës si dhe 5%(pesë për qind) që destinohet për fondet e rezervës së domosdoshme, derisa kjo të ketë arritur kufirin e parashikuar me ligj.

Pjesa që mbetet pas zbritjes së zërave të mësipërm, do t'u shpërndahet pronarëve të kuotave të kapitalit themeltar përpjesëtimisht me pjesëmarrjen e tyre, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, me përjashtim të destinimit të ndryshëm të vendosur nga vetë ortakët.

NENI 22 **FINANCIMI I ORTAKËVE**

Shoqëria mund të marrë nga ortakët financime me ose pa shpërblim, nëpërputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Dhënia e këtyre financimeve nga ana e ortakëve është e lirë.



NENI 23
MBYLLJA E AKTIVITETIT

Veprimtaria e shoqërisë pushon me vendim të Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë kur:

1. Veprimtaria e shoqërisë është negative;
2. Veprimtaria e shoqërisë është e pamundur;
3. Shpërndahet me vullnet të ortakëve;
4. Riorganizohet nënjë formë tjetër;
5. Si dhe në çdo rast tjetër të parashikuar nga ligji.

NENI 24
LIKUIDIMI

Kur verifikohet një nga shkaqet e parashikuara në Nenin 23 të këtij Statuti, Asambleja e Ortakëve cakton një ose më shumë likuidatorë të cilët do të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për likuidimin e saj, duke likuiduar në radhë të parë detyrimet e shoqërisë ndaj shtetit e më pas ndaj të tretëve.

Në rast se kapitali i shoqërisë do të jetë i pamjaftueshëm, ortakët e shoqërisë kanë detyrimin për të derdhur kuotat e tyre deri në nivelin e pjesëmarrjes në kapitalin fillestar.

NENI 25
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet ortakëve ose ndërmjet ortakëve dhe shoqërisë dhe që ka lidhje me të drejta të disponueshme në lidhje me marrëdhëniet e tyre me shoqërinë do t'i drejtohen për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

NENI 26
LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

Çdo gjë që nuk është parashikuar në këtë statut do të disiplinohet nga dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Peshkopi më. 01.10.2024

Ortakët e shoqërisë "DIBRA FRUIT" sh.p.k

Z. Robert ZEBI

